



Në mbështetje të nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 36-të të mbajtur më 26.08.2015, mori:

## V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2019:
  - Mjekësi Veterinare, DMV (300 ECTS), me kushte që të plotësohet rekomandimi i ekipit të ekspertëve për punimin tezës së diplomës për të gjithë kandidatët në fund të studimeve, dhe të korrigohet llogaritja dhe alokimi i ECTS kredive.
  - Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc (180 ECTS).
  
- II. Akreditohet programi i studimit për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2015 – 30 shtator 2018:
  - Master në Shëndetin Publik (60 ECTS), me kushte që të korrigohet numëri i orëve të ngarkesës së studentëve që korrespondon me numrin e kredive në program.

## Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e shënuara me lartë, raportin final të hartuar nga ekipit i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit, dhe bazuar në Udhëzimit Administrativ për Akreditim 02/2013, datë 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i ekspertëve (në të dy gjuhët, shqip dhe anglisht dhe në të dy versionet, të shtypur dhe elektronik në CD) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim deri më 30 Tetor 2015.

**Këshilla juridike:** Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas afatit të përcaktuar me Ligjin mbi Procedurën Administrative Nr. 02/L-28, datë 22 korrik 2005.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi u dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



---

Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë